

V E N D I M
Nr.268, datë 7.6.1993

**PËR MIRATIMIN E "MARRËVESHJES SË TRANSPORTIT AJROR
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
FEDERALE TË AUSTRISË**

Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e "Marrëveshjes së transportit ajror ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Federale të Austrisë", e cila u nënshkrua në Vjenë më 18 mars 1993.

Shkronja "c" e pikës 4 të nenit 7 të kësaj marrëveshje të interpretohet si vijon:

"Përgjashtimi nga taksa doganore bëhet vetëm për vleftën materiale të dokumentacionit dhe jo për vleftën e shërbimeve që ai përfaqëson".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi